



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI**  
**REGULATORNI URED ZA ENERGIJU**  
**ENERGY REGULATORY OFFICE**



**Rregulla ZRRE/Nr.02 /2023**

## **RREGULLA**

**PËR PËRGATITJEN DHE VLERËSIMIN E PLANEVE ZHVILLIMORE DHE  
INVESTIVE TË OPERATORËVE TË SISTEMEVE NË SEKTORIN E ENERGISË**

**Prishtinë, 05 korrik 2023**



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në pajtim me Nenin 9 par. 1 nënpar. 1.7, Nenin 15 paragrafi 7 nënparagrafi 7.6, paragrafët 8, 9, 10 dhe 11, Nenin 25 dhe Nenin 26 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1, të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-84); Neni 16 paragrafi 1 nënparagrafët 1.11, 1.12, 1.13, Nenin 28 paragrafi 1 nënparagrafet 1.25, 1.26, 1.27, 1.28 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-85); dhe Nenin 10 të Ligjit për Energji (Ligji Nr. 05/L-081), në seancën e mbajtur më 05 korrik 2023 miratoi:

## **RREGULLËN PËR PËRGATITJEN DHE VLERËSIMIN E PLANEVE ZHVILLIMORE DHE INVESTIVE TË OPERATORËVE TË SISTEMEVE NË SEKTORIN E ENERGISË**

### **KAPITULLI I**

#### **Dispozitat e përgjithshme**

##### **Neni 1**

#### **Qëllimi dhe Fushëveprimi**

1. Qëllimi i kësaj Rregulle është definimi i metodologjisë dhe renditja e hapave për përgatitjen dhe vlerësimin e Planeve Zhvillimore dhe Investive të Operatorëve të Sistemeve në sektorin e energjisë në Kosovë, përfshirë këtu edhe vlerësimin e Projekteve Kapitale që do të jenë pjesë e Planeve Zhvillimore dhe Investive, si dhe përcaktimi i metodologjisë për vlerësimin rregullator të Planeve Zhvillimore dhe Investive.
2. Kjo Rregull përcakton:
  - 2.1 Procesin e dorëzimit nga Operatorët e Sistemeve (të licencuarëve) të Planeve Zhvillimore dhe Investive, përfshirë projektet kapitale të propozuara për investime, kostot e të cilave duhet të mbulohen nga tarifat e rregulluara, si pjesë e çdo Shqyrtimi Tarifor Shumëvjeçar, i cili përmban:
    - 2.1.1 Procesin e përgatitjes dhe metodologjisë së zbatuar për përgatitjen e planeve Zhvillimore dhe Investive;
    - 2.1.2 Kërkesat që duhet të plotësojnë Planet Zhvillimore dhe Investive për t'u dorëzuar tek Rregullatori për shqyrtim dhe aprovim;
    - 2.1.3 Të dhënat, dëshmitë dhe arsyetimet që duhet të dorëzohen nga Operatorët e Sistemeve të lartpërmendur për të mbështetur Planet e tyre Zhvillimore, përfshirë planet e investimeve;
    - 2.1.4 Parimet për kryerjen e një analize ekonomike kosto përfitim dhe atyre teknike për arsyetimin e projekteve;



- 2.1.5 Vlerësimin nga Rregullatori për arsyeshmërinë e Planeve Zhvillimore dhe Investive të propozuara për aprovim, përfshirë planet investive afatëshkurta dhe ato afatëgjata; dhe
      - 2.1.6 Monitorimin e zbatimit të Planeve Zhvillimore dhjetë vjeçare.
3. Planet Zhvillimore dhe Investive të parashtruara për aprovim duhet të jenë në pajtim me Strategjinë e Energjisë, Planin Kombëtar për Energji dhe Klimë, ligjet e sektorit të energjisë, legjislacionin tjetër të aplikueshëm, si dhe të jenë në përputhje me rregullat, licencat e lëshuara nga Rregullatori, kodet dhe normat tjera të aplikueshme në sektorin e energjisë, të aprovuara nga Rregullatori apo institucionet tjera kompetente.
4. Nëse Planet Zhvillimore dhe Investive nuk janë në përputhje me paragrafin 3 të këtij Neni, atëherë Rregullatori do të kërkojë nga Operatorët e Sistemeve që të bëjnë plotësimet dhe ndyshimet e nevojshme, para se planet të dorëzohen për aprovim në Rregullator.
5. Planet Zhvillimore të OST dhe OSSH të energjisë elektrike duhet të jenë Plane pesë (5) Vjeçare dhe Plane dhejtë (10) Vjeçare, ndërsa Planet pesë (5) Vjeçare duhet të jenë në pajtim me planet 10 vjeçare.
6. Planet Investive duhet të jenë Plane 5 Vjeçare për OST që dërgohen çdo vit për aprovim dhe Plane Një (1) Vjeçare për OSSH që dërgohen çdo vit për aprovim dhe duhet të jenë në harmoni me të gjitha Planet Zhvillimore.
7. Kostoja e planifikuar për zbatimit të Planeve Zhvillimore do të jenë njëri prej elementeve bazë në caktimin e tarifave për konsumator në shqyrtimin tarifor nga Rregullatori.

## Neni 2

### Përkufizimet dhe interpretimi

1. Termat e përdorur në këtë Rregull kanë kuptimin e mëposhtëm:
  - 1.1 **Plani Zhvillimor Dhjetë Vjeçar i Rrjetit (në tekston e mëtejme: PZHDHVR)** – planifikimi dhjetë vjeçar (10) i nevojave për investime në kapacitetet e transmetimit apo shpërndarjes me synim të plotësimin të kërkesave të sistemit për energji dhe sigurimin e furnizimit të konsumatorëve, i cili aprovohet nga Rregullatori.
  - 1.2 **Plani Zhvillimor Pesë Vjeçar i Rrjetit (në tekston e mëtejme: PZHPVR)** – planifikimi pesë vjeçar (5) i nevojave për investime në kapacitetet e transmetimit apo shpërndarjes me synim të plotësimin të kërkesave të sistemit për energji dhe sigurimin e furnizimit të konsumatorëve, i cili aprovohet nga Rregullatori.
  - 1.3 **Plani Pesëvjeçar Investiv (në tekston e mëtejme: PPVI)** – është përgjegjësi për OST për energji elektrike dhe nënkupton planifikimin, zhvillimin dhe publikimin, brenda vitit, që i



paraprinë vitit të parë të Planit investiv, Planin investiv pesë (5) vjeçar, të miratuar paraprakisht nga Rregullatori të harmonizuar me Planin dhjetë (10) vjeçar dhe atë pesë (5) vjeçar të zhvillimit të rrjetit të transmetimit dhe dokumentacionit të planifikimit hapësinor.

1.4 **Plani njëvjeçar Investiv - (në tekston e mëtejme: PNJVI)** përpilimi brenda vitit aktual i Planit investiv një (1) vjeçar të OSSH për energji elektrike për vitin e ardhshëm, i cili miratohet nga Rregullatori, në pajtim me Planin dhjetë (10) vjeçar dhe Planin pesë (5) vjeçar të zhvillimit të rrjetit të shpërndarjes dhe me dokumentacionin e planifikimit hapësinor;

1.5 **Plani Vjetor i Humbjeve (në tekston e mëtejme: PVH):** përfshin vlerësimin e humbjeve teknike dhe konsumin e paautorizuar të energjisë elektrike, përgatitet nga OSSH për energji elektrike brenda vitit aktual për vitin pasues dhe dërgohet për aprovim te Rregullatori;

1.6 **Operatorët e Sistemeve** janë:

1.6.1 **Operator i Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike** (në tekstin e mëtejme: **OST**) – person fizik ose juridik përgjegjës për operimin, mirëmbajtjen dhe sipas nevojës, zhvillimin e rrjetit të transmetimit në një zonë të caktuar dhe kurdo që kjo është e mundur, interkonektorët me sistemet tjera dhe për të garantuar aftësinë afatgjate të rrjetit për të përmbushur kërkesat për transmetimin e energjisë elektrike.

1.6.2 **Operatori i Sistemit të Shpërndarjes të energjisë elektrike** (në tekstin e mëtejme: **OSSH**) - person fizik ose juridik, përgjegjës për operimin, mirëmbajtjen dhe sipas nevojës zhvillimin e sistemit të shpërndarjes në një zonë të caktuar, si dhe ku është e mundur interkonektorët e tij me sistemet tjera, si dhe për sigurimin e aftësisë afatgjatë të sistemit për të mbuluar kërkesat e arsyeshme për shpërndarjen e energjisë elektrike.

1.6.3 **Operatori i Sistemit të Transmetimit të Gazit Natyror** (në tekstin e mëtejme: **OSTGN**) – person fizik apo juridik që kryen funksionin e transmetimit dhe që është përgjegjës për operimin, mirëmbajtjen dhe sipas nevojës, zhvillimin e sistemit të transmetimit në një zonë të caktuar, përfshirë edhe interkonekcionet e mundshme me sistemet tjera, dhe për garantimin e aftësinë afatgjate të sistemit për të plotësuar kërkesë për transmetimin e gazit natyror.

1.6.4 **Operatori i Sistemit të Shpërndarjes të Gazit Natyror** (në tekstin e mëtejme: **OSSHGN**) - person fizik apo juridik që kryen funksionet e shpërndarjes dhe është përgjegjës për operimin, mirëmbajtjen dhe sipas nevojës, zhvillimin e sistemit të shpërndarjes, në një zonë të caktuar përfshirë edhe interkonekcionet e mundshme me sisteme tjera dhe për garantimin e aftësinë afatgjate të sistemit për të plotësuar kërkesën për shpërndarjen e gazit natyror.

1.6.5 **Operatori i Sistemit të Shpërndarjes të Energjisë Termike** (në tekstin e mëtejme: **OSSHET**) - personi juridik ose fizik i licencuar, përgjegjës për operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të transportimit dhe shpërndarjes së energjisë termike.



- 1.7 **Analiza e Kost-Benefitit** (në tekstin e mëtejshëm: **AKB**) – procesi i përcaktimit të kostove dhe përfitimeve nga një projekt gjatë një periudhe të caktuar dhe alternativave të tij brenda të njejtës periudhë në mënyrë që të ketë shkallë të arsyeshme të krahsimit për një vlerësim të drejtë.
- 1.8 **Shprehja 'projekt'**- përdoret për t'iu referuar edhe projekteve të mëdha individuale dhe programeve të shumëfishta të projekteve të vogla për të cilat aplikohet AKB.
- 1.9 **Rrjeti Evropian i Operatorëve të Sistemit të Transmisionit për Energji Elektrike** ose ENTSO-E.
- 1.10 **Rrjeti Evropian i Operatorëve të Sistemit të Transmisionit për Gaz Natyror** (në tekstin e mëtejshëm: **ENTSO-G**).
- 1.11 **Periudha Regullative** – Përcaktimi i të hyrave të lejuara maksimale për periudhën rregullative që përcaktohen gjatë shqyrtimeve periodike të rregullta 5 vjeçare.
- 1.12 **Vlera Neto e Tanishme** (në tekstin e mëtejshëm: **VNT**).
- 1.13 **Vlera e Ngarkesës së Humbur** (në tekstin e mëtejshëm: **VNH**) – vlerësimi i gatishmërisë së konsumatorëve për të paguar kosto shtesë për të përmirësuar cilësinë e furnizimit.
- 1.14 **Zyra e Rregullatorit për Energji** (në tekstin e mëtejshëm: **ZRRE**) – është agjenci e pavarur në sektorin e energjisë, e themeluar me ligjin për Rregullatorin e Energjisë.
- 1.15 **Tensioni i Ultë** (në tekstin e mëtejshëm: **TU**).
- 1.16 **Tensioni i Mesëm** (në tekstin e mëtejshëm: **TM**).
- 1.17 **Tensioni i Lartë** (në tekstin e mëtejshëm: **TL**).
- 1.18 **Konsumator vetë-prodhues** (në tekstin e mëtejshëm: ose **Prosumer**), konsumatori i cili konsumon energji nga sistemi, por i cili mund edhe të prodhojë energji dhe të fusë në sistem.
- 1.19 **Burime të Ripërtërtishme të Energjisë** (në tekstin e mëtejshëm: **BRE**).
- 1.20 **Energjia e Elektrike e Pafurnizuar** (në tekstin e mëtejshëm: **EEP**) – është energjia elektrike që nuk është furnizuar te konsumatorët.
- 1.21 **Kohëzgjatja Mesatare e Ndërprejeve të Furnizimit me Energji Elektrike** (në tekstin e mëtejshëm: **KMNFE**).



- 1.22 **Kapaciteti Transmetues i Rrjetit** (në tekstin e mëtejshëm: **KTR**) – është kapaciteti transmetues i rrjetit të transmetimit në **MW**.
2. Çdo term që nuk është përdorur në këtë Rregull kduhet të interpretohet në pajtim me Ligjin (Nr. 05/L-084) për Rregullatorin e Energjisë, Ligji (Nr. 05/L-081) për Energjinë, Ligji (Nr. 05/L-085) për Energjinë Elektrike, dhe ligjet tjera të aplikueshme në Kosovë.

## **KAPITULLI II**

### **PROCESI I PËRGATITJES SË PLANEVE ZHVILLIMORE**

#### Neni 3

#### **Përgatitja e Planeve Zhvillimore**

Operatorët e Sistemeve gjatë përgatitjes së Planeve Zhvillimore duhet të marrin parasysh:

1. Politikat zhvillimore të shtetit të Kosovës.
2. Strategjinë e Energjisë të aprovuar nga Kuvendi i Kosovës.
3. Planin Kombëtarë për Energji dhe Klimë.
4. Nevojën e integritit të burimeve të ripërtëritshme.
5. Nevojën e hapjes së tregut dhe integritimeve rajonale të tregut të energjisë, dhe
6. Planet Zhvillimore Komunale.

#### Neni 4

#### **Struktura dhe përbajtja e Planeve Zhvillimore**

1. Planet Zhvillimore të Operatorëve të Sistemeve duhet të kenë strukturë dhe pëmbajtje ku paraqiten:
  - 1.1 Qëllimi dhe përbajtja e planeve;
  - 1.2 Metodologjia e përgatitjes së planeve, Standardet dhe Kriteret e Planifikimit;
  - 1.3 Karakteristikat aktuale të sistemeve të transmetimit dhe shpërndarjes të energjisë (energjisë elektrike, energjisë termike dhe gazit natyror), përfshirë pikat e dobëta, sfidat dhe mundësitë përfshirë:
    - 1.3.1 Burimet e energjisë (gjeneratorëve) të kyqur në rrjetin e sistemit të transmetimit (OST, OSTGN) apo të sistemit të shpërndarjes (OSSH, OSSHET, OSSHGN),
    - 1.3.2 Sistemeve të niveleve të ndryshme të tensionit të energjisë elektrike për OST-së dhe OSSH-së (TU, TM, dhe TL); si dhe niveleve të ndryshme të presionit apo temperatures për energjinë termike dhe të gazit natyrorë,



- 1.3.3 Interkonekcioneve;
  - 1.3.4 Nënstacioneve;
  - 1.3.5 Lidhjeve dhe sistemeve matëse; dhe
  - 1.3.6 Konsumatorëve, përfshirë konsumatorët-vetëprodhues (prosumers).
- 2. Parashikimi i kërkesës dhe skenaret e gjenerimit, përfshirë burimet e ripërtëritshme dhe integrimet e tregut.
  - 3. Simulimet aktuale të sistemit dhe supozimet e planifikuara.
  - 4. Vizionin dhe caktimi i elementeve drejtuese të zhvillimeve të sistemit.
  - 5. Planifikimi i Zhvillimit të Sistemit, Planifikimi Kohor, Analiza e Kost Benefitit.
  - 6. Analiza e Riskut dhe Senzitivitetit.
  - 7. Shtojcat me studime teknike, financiare dhe fazat e zhvillimit të projekteve.

## Neni 5

### **Situata aktuale e sistemeve**

- 1. Me qëllim të indentifikimit të projekteve të nevojshme për t'u vendosur në Planin Zhvillimor, Operatorët e Sistemeve duhet që në kapitull të veçantë të paraqesin situatën aktuale të sistemeve të tyre.
  - 1.1 OST dhe OSSh të energjisë elektrike duhet të paraqesin gjendjen e linjave dhe NS duke i renditur sipas nivelit të tensioneve përfshirë këto të dhëna:
    - 1.1.1. Kapacitetin egzistues të stabilimenteve;
    - 1.1.2. Ngarkesën e stabilimenteve egzistuese;
    - 1.1.3. Tensioni në fund të linjës;
    - 1.1.4. Numrin dhe kohëzgjatjen e ndërprerjeve të paplanifikuara për vitin paraprak;
    - 1.1.5. Kërkesat për kyqje në tri vitet e fundit;
    - 1.1.6. Numrin e konsumatorëve;
    - 1.1.7. Numrin e ankesave të konsumatorëve;
    - 1.1.8. Humbjet teknike;
    - 1.1.9. Humbjet komerciale;
    - 1.1.10 Ngarkesat e linjave, NS-ve,
    - 1.1.11 Vjetërsia e stabilimenteve;



- 1.1.12 Të dhënat ekzistuese të stabilimenteve të cilat i disponon operatori (distrikti, kodi, nënstacioni, dalja dhe nr.njehsorit).
- 1.2 Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Termike (OSSHET) duhet të paraqesë gjendjen e gypave dhe NS përfshirë këto të dhëna:
  - 1.2.1. Kapacitetin ekzistues;
  - 1.2.2. Temperaturën dhe presioni në rrjet, gjegjësisht në segmentet kryesore të rrjetit;
  - 1.2.3. Numrin dhe kohëzgjatjen e nderprerjeve të paplanifikuara për vitin paraprak;
  - 1.2.4. Kërkesat për kyqje në tri vitet e fundit;
  - 1.2.5. Numrin e konsumatorëve;
  - 1.2.6. Numrin e ankesave të konsumatorëve;
  - 1.2.7. Humbjet teknike;
  - 1.2.8. Humbjet komerciale;
  - 1.2.9 Vjetërsia e stabilimenteve;
  - 1.2.10 Të dhënat ekzistuese të stabilimenteve të cilat i disponon operatori (distrikti, kodi, nënstacioni, dhe nr.njehsorit).
2. Për Operatorin e e sistemit të transmetimit dhe operatorin e shpërndarjes të gazit natyror (kur të jenë në operim) do të kërkohen të dhëna adekuate sipas natyrës specifike të shërbimeve.

## Neni 6

### **Situata aktuale në vend dhe perspektiva**

1. Gjatë përgatitjes së Planeve Zhvillimore, Operatorët e Sistemeve duhet të përshkruajnë situatën aktuale në vend me fokus në:
  - 1.1. Zhvillimin aktual ekonomik;
  - 1.2. Kushtet energjetike;
  - 1.3. Kushtet dhe kufizimet mjedisore; dhe
  - 1.4. Caqet e përcaktuara në sektorin e energjisë.





2. Gjithashtu, duhet të përshkruhet perspektiva e evoluimit të çështjeve të theksuara në paragrafin 1 të këtij Neni.

#### Neni 7

##### **Analiza e Kërkesës**

Operatorët e Sistemeve do t'i përgatisin Planet Zhvillimore dhe Planet Investive duke analizuar kërkesën historike, aktuale, parashikimet për kërkesën për energji, përfshirë kërkesën maksimale (pikun), si dhe trendet e këtyre parametrave në periudhën 5 dhe 10 vjeçare. Në parashikimin e kërkesës për energji, Operatorët e Sistemeve në veçanti duhet analizuar: efektin e kushteve të motit-temperaturës, si dhe parametrat kryesorë ekonomik (Bruto Produkti Vendor - BPV).

#### Neni 8

##### **Caktimi i parametrave drejtues të Planeve Zhvillimore**

1. Bazuar në analizat dhe vlerësimet e përshkruara në Nenin 6 dhe 7 të kësaj Rregulle, si dhe planifikimet për zhvillimin strategjik të vendit, Planet Zhvillimore duhet të marrin parasysh këta parametra drejtues:
  - 1.1. Sigurinë dhe cilësinë e furnizimit me energji;
  - 1.2. Përbushjen e besueshmërisë së sistemit, përbushja e kriterëve teknike;
  - 1.3. Të siguroj qasjen e kyçjes së kapaciteteve të reja në sistem;
  - 1.4. Zhvillimin e infrastrukturës për integrimin e BRE-ve në sistem, si dhe integrimin e konsumatorëve vetëprodhues (Prosumers)
  - 1.5. Zhvillimin e rrjetit për hapjen e tregut dhe për integrime rajonale;
  - 1.6. Problemet teknike në sistem (niveli i tensionit, kongestionet apo "fytat e ngushtë" për OST dhe OSSH, apo niveli i temperaturës dhe presionit për OSTGN, OSSHT dhe OSSHGN).

#### Neni 9

##### **Përgatitja e skenareve të ndryshëm të Planeve Zhvillimore**

1. Në përgatitjen e Planeve Zhvillimore, gjithashtu duhet të merren parasysh skenaret e ndryshëm që janë të paraparë në dokumentet strategjike të zhvillimit të vendit, si dhe skenarët e ndryshëm të zhvillimit në sektorin e energjisë.
2. Për secilën skenar që parashihet në paragrafin 1 të këtij Neni, Operatorët e Sistemeve duhet të përgatisin:



- 2.1. Zhvillimet e nevojshme të sistemeve transmetuese dhe shpërndarëse për vite të caktuara;
- 2.2. Ekzaminimet fillestare, simulimet e sistemit;
- 2.3. Studime dhe analiza të rrjetit;
- 2.4 Studime dhe analiza me skenarë të furnizimit , prodhimit , importet dhe eksportet;
- 2.5 Skenarët e infrastrukturës të lidhur me gjenerimin e synuar, Interkoneksionet, kufijtë e rezervës; dhe
- 2.6. Identifikimin e projekteve të domosdoshme sipas skenareve të ndryshme.

#### Neni 10

### **Përgatitja e Planeve Zhvillimore Dhjetëvjeçare me ndikim rajonal nga Operatorët e Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike (OST) dhe të gazit natyror (OSTGN)**

Gjatë përgatitjes të planit dhjetë (10) vjeçar të Zhvillimit të Rrjetit, Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST apo OSTGN) bëjnë supozime të arsyeshme për zhvillimin e gjenerimit, furnizimit, konsumit dhe shkëmbimeve me vendet tjera, duke i marrë parasysh planet e investimit për rrjetet rajonale në kuadër të Komunitetit të Energjisë. Për interkoneksione me vendet fqinje investimet në infrastrukturë për projekte të përbashkëta duhet marrur parasysh alokimin e kostos ndërkufitare përmes analizës kost-benefit dhe statusin e projektit me vendet fqinje.

#### Neni 11

### **Obligimet ligjore në përgatitjen e Planeve Zhvillimore të Operatorëve të Sistemeve**

1. Obligimet ligjore për përgatitjen dhe dorëzimin e Planeve Zhvillimore dhjetëvjeçare nga Operatorët e Sistemeve janë të përcaktuara në Nenin 10 të Ligjit për Energjinë dhe definojnë:
  - 1.1 Shpeshtësinë (çdo vit) e dorëzimit të Planeve Zhvillimore dhjetë (10) vjeçare për zhvillimin e sistemit në bazë të kërkesës dhe furnizimit aktual dhe të parashikuar pas konsultimit më të gjithë akterët relevant. Plani i zhvillimit të rrjetit përmban masa efikase në mënyrë që të garantojë përshtatshmërinë e sistemit dhe sigurinë e furnizimit.
  - 1.2 Përmbajtjen e Planeve-dhjetë (10) vjeçare për zhvillimin e sistemeve me fokus në:
    - 1.2.1 njoftimin e pjesëmarrësve kryesor të tregut për infrastrukturën që nevojitet të ndërtohet apo të përmirësohet gjatë dhjetë (10) vjetëve të ardhshme;
    - 1.2.2 projektet që janë në zhvillim dhe identifikimi i projekteve të reja që do të ekzekutohen gjatë dhjetë (10) viteve të ardhshme; dhe
    - 1.2.3 përgatitjen e kornizës kohore për të gjitha projektet sipas paragrafit 1.2.2 të këtij Neni.



2. Obligimet ligjore për përgatitjen dhe dorëzimin e Planeve Zhvillimore Pesëvjeçare nga Operatorët e Sistemeve janë të përcaktuara në Nenin 16, paragrafi 1.12 dhe Nenin 28, paragrafi 1.27 të Ligjit për Energjinë Elektrike dhe definojnë:

2.1 përpilimi brenda vitit që i paraprinë periudhës pesë (5) vjeçare, planin pesë (5) vjeçar për zhvillimin e rrjetit të transmetimit dhe duhet të jetë i harmonizuar me Planin dhjetë (10) vjeçar të zhvillimit të rrjetit të transmetimit, dokumentacionin e planifikimit hapësinor dhe të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes;

2.2 zhvillimi i planit pesë (5) vjeçar për zhvillimin e rrjetit të shpërndarjes brenda vitit aktual për periudhën pesë (5) vjeçare që duhet të jetë në harmoni me planin dhjetë (10) vjeçar të zhvillimit të rrjetit të shpërndarjes, me dokumentacionin e planifikimit hapësinor dhe me planin pesë (5) vjeçar të zhvillimit të rrjetit të transmetimit.

#### Neni 12

##### **Lista e projekteve që do të përfshihen në Planet Zhvillimore**

1. Në listen e projekteve që do të përfshihen në Planet Zhvillimore mund të vendosen ato projekte apo programe që janë:

1.1. në funksion të realizimit të kërkesë për energji sipas Nenit 7, të kësaj Rregulle;

1.2. në funksion të realizimit të parametrave drejtues sipas Nenit 8, të kësaj Rregulle;

1.3. në harmoni me skenarin e rekomanduar të zhvillimit sipas Nenit 9, të kësaj Rregulle;

1.4. në funksion të përmbushjes së obligimeve sipas Nenit 11, të kësaj Rregulle si dhe

1.5 të “arsyeshëm” sipas AKB.

#### Neni 13

##### **Kodifikimi i projekteve për Planet Zhvillimore dhe Investive**

Të gjitha projektet të cilat do të propozohen për zbatim në planet zhvillimore dhe ato investive duhet të kenë të caktuar një Kod i cili do të përdoret në të gjitha fazat e planifikimit, zbatimit të projektit dhe monitorimit.

#### Neni 14

##### **Identifikimi i projekteve shtesë për Planet Zhvillimore**

1. Operatorët e Sistemeve do të indentifikojnë projekte shtesë të cilat do të mund të vendosen në Planet Zhvillimore e që sipas nevojës mund të jenë në funksion të realizimit të objektivave strategjike të vendit apo sektorit të energjisë në vend dhe rajon.



2. Projektet shtesë të identifikuar sipas Paragarfit 1 të këtij Neni duhet t'i plotësojnë të gjitha kushtet si të gjitha projektet tjera të përfshira në Planet Zhvillimore.

## Neni 15

### **Përmbajtja e Planit Pesëvjeçar Investiv për OST dhe OSSH**

1. Planit Pesëvjeçar Investiv i OST dhe Planit Pesëvjeçar Investiv i OSSH-së, të energjisë elektrike që do të dorëzohet te Rregullatori duhet të jetë në harmoni me Planin Zhvillimor të sistemeve përkatëse.
2. Në rast se ka dallim ndërmjet Planeve Pesëvjeçare Investive të OST dhe OSSH me Planet Zhvillimore të fundit të miratuara nga Rregullatori, Operoret e Sistemit duhet të japin arsyeshmërinë për këto ndryshime apo plotësime.
3. Planit Pesëvjeçar Investiv për OST dhe Planit Pesëvjeçar Investiv për OSSH që do të dorëzohet te Rregullatori duhet të përmbaj, së paku, këto elemente:
  - 3.1 Një shpjegim për Metodologjinë e përdorur për përgatitjen e Planit Pesëvjeçar Investiv (OST) dhe Planit Pesëvjeçar Investiv (OSSH) dhe për procesin e identifikimit dhe përfshirjes së kërkesave të shfrytëzuesve të sistemeve;
  - 3.2 Një përmbledhje të Planit Pesëvjeçar Investiv (OST) dhe Planit Pesëvjeçar Investiv (OSSH) që tregon shpenzimet e pritshme dhe vlerat e komisionimit të asteve në çdo vit të periudhës rregullative;
  - 3.3 Një grup i rezultateve të përcaktuara të cilat do të arrihen nga Planit Pesëvjeçar Investiv (OST) dhe Planit Pesëvjeçar Investiv (OSSH), kundrejt të cilave do të vlerësohet performanca e të licencuarit;
  - 3.4 Një listë e të gjitha projekteve të mëdha individuale që do të ndërmerren në kuadër të PPVI (OST) dhe PPVI (OSSH), e shoqëruar me një përmbledhje të përshkrimit teknik, vlerësime të kostos, plan të zbatimit dhe arsyetim për nevojën e projektit duke përfshirë paraqitjen e alternativave që janë marrë parasysh;
  - 3.5 Një listë e grupimeve të projekteve të vogla që do të ndërmerren në kuadër të PPVI (OST) dhe PPVI (OSSH), të shoqëruar me një përmbledhje të përshkrimit dhe arsytimit teknik, vlerësime të kostos dhe plan të zbatimit;
  - 3.6 Në rast kur një projekt ose grup i projekteve të vogla tejkalon pragun e përcaktuar, një analizë ekonomike të kost-benefitit (AKB) për atë projekt ose program duhet të dërgohet tek Rregullatori;
  - 3.7 Një renditje prioritare dhe grupeve të projekteve të vogla të përfshira në PPVI (OST) dhe PPVI (OSSH); dhe



- 3.8 Një përshkrim të rreziqeve kryesore në arritjen e Planit Pesëvjeçar Investiv të OST, gjegjësisht Planit Pesëvjeçar Investiv të OSSH-së dhe mënyrën se si operatori i sistemit tenton/planifikon që të tejkaloi, zbusë ose menaxhoj ato.
4. Të gjitha projektet e mëdhaja dhe grupet e projekteve të vogla që do të përfshihen në Planin Pesëvjeçar Investiv të OST-së, gjegjësisht Planit Pesëvjeçar Investiv të OSSH-së, duhet të kenë të përfunduar një studim të para-fizibilitetit dhe fizibilitetit. Këto studime mund të përjashtohen vetëm pas dërgimit të kërkesës me arsyeshmëri nga i licencuari dhe aprovimit të saj nga Rregullatori.
  5. Për qëllime të paragrafit 3.4 të këtij Neni, një projekt i “madh” në sistem të transmetimit duhet të përkufizohet si një projekt me një kosto të vlerësuar kapitale të barabartë me ose më të madhe se 300,000 € ose një kufizim të tillë tjetër për të cilin Rregullatori mund të njoftoj kohë pas kohe të licencuarit.
  6. Për qëllime të paragrafit 3.4 të këtij Neni, një projekt ‘i madh’ në sistem të shpërdarjes duhet të përkufizohet si një projekt me një kosto të vlerësuar kapitale të barabartë me ose më të madhe se 100,000 € ose një kufizim të tillë tjetër për të cilin Rregullatori mund të njoftoj kohë pas kohe të licencuarit.
  7. Rregullatori në bashkëpunim me Operatorët e Sistemit do të zhvillojë formularët që do të përdoren për vlerësimin e projekteve kapitale.
  8. Për qëllime të paragrafit 3.6 të këtij Neni, pragu për një projekt ose program individual të projekteve të shumta për të cilat duhet të bëhet analiza kost-benefit duhet të jetë mbi 1 milion €.
  9. Rregullatori mund të kërkojë nga i licencuari analizën e kost benefitit edhe për projekte ose për grupe të projekteve të vogla nën vlerën 1 milion €.



## Neni 16

### **Vlerësimi Rregullator dhe Publikimi i Planit Pesëvjeçar Investiv për OST dhe OSSH**

1. Pas pranimet të Planit Pesëvjeçar Investiv (PPVI) për OST dhe Planit Pesëvjeçar Investiv (PPVI) për OSSH, Rregullatori do të publikoj Raportin e vetë të vlerësimit jo më vonë se me datë 30 shtator të të njëjtit vit, i cili do të identifikoi se:
  - 1.1 Cilat projekte dhe grupe të projekteve të vogla Rregullatori propozon të përfshihen në të hyrat e lejuara që do të mbulohen gjatë periudhës së ardhshme rregullative dhe nivelin e shpenzimeve për vit;
  - 1.2 Cilat projekte dhe grupe të projekteve nuk do të përfshihen në të hyrat e lejuara dhe cilat projekte do të përfshihen me një kosto tjetër kapitale nga ajo që është paraqitur nga operatorët e sistemit, për secilin rast do të jepet një shpjegim i arsyeshëm.
2. Raportet e vlerësimit do të jenë determinuese për llogaritjen e të hyrave të lejuara që do të mbulohet në kuadër të periudhës rregullative të ardhshme, andaj Rregullatori ka të drejtë që të përfshijë ose përjashtojë ndonjë projekt ose program individual nga këto të hyra të lejuara ose koston kapitale të bashkangjitur në ndonjë projekt ose program individual të përfshirë.
3. Plani Final i Investimeve do të përcaktohet si pjesë e vendimit Final të Shqyrtimit Tarifor për Periudhën Rregullative pas procesit të Konsultimit Publik dhe analizës së të hyrave të lejuara që janë propozuar dhe do të publikohen në faqen elektronike të Rregullatorit.
4. Pas publikimi të Planit Final të Investimeve, nga të licencuarit pritet që të zbatojnë këtë në mënyrë të plotë, mirëpo në raste të veçanta kur gjatë periudhës rregullative vlerësohet se projektet ose



programet individuale më nuk janë të domosdoshme ose mund të zavendësohen me alternativa që ofrojnë rezultat ekuivalente ose edhe më të mira me një kosto më të ulët për jetëgjatësinë e tyre.

5. Të licencuarit do të raportojnë në baza vjeore te Rregullatori rreth progresit në zbatimin e planit të investimve, duke identifikuar çdo vonesë nga plani dhe duke shpjeguar arsyet për to.
6. Të licencuarit gjithashtu do të raportojnë në baza vjetore për shpenzimet e përgjithëshme kapitale sipas projektit ose programit individual dhe në total kundrejt atyre në planin final të investimeve të identifikuar dhe duke shpjeguar çdo mospërputhje në mes të planit dhe vlerave aktuale.
7. Gjatë shqyrtimit të periudhës së ardhëshme të rregullt rregullative, Rregullatori do të marrë parasysh performancën e operatorëve të sistemeve kundrejt planeve të aprovuara në periudhë paraprake rregulative.

#### Neni 17

#### **Planet Investive Njëvjeçare**

1. Në pajtim me Nenin 28 paragrafi 1.28 të Ligjit për Energjinë Elektrike, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes duhet të përgatisë dhe të paraqes për aprovim te Rregullatori Planin Investiv Njëvjeçar.
2. Plani Investiv Njëvjeçar duhet të jetë në harmoni me planet tjera dhe duhet të përmbajë:
  - 2.1. Projektet që do të kompletohen në vitin e parë të zbatimit të Planeve Zhvillimore
  - 2.2. Projektet që do të fillojnë në vitin e parë dhe do të vazhdojnë në vitet pasuese
  - 2.3. Afatet kohore të zbatimit të projekteve që do të përfundojnë në vitin e parë, si dhe parashikimin e realizimit në % të projekteve që fillojnë në vitin e parë por që vijojnë në vitet pasuese
  - 2.4. Koston e investimeve për projektet të planifikuar për t'u zbatuar në vitin e parë
3. Plani Investiv Njëvjeçar do të dorëzohet te Rregullatori si plan me të dhëna më të detajuara për secilin projekt.
4. Në rastin kur ka ndryshime ndërmjet investimeve kapitale të lejuara dhe realizuara gjatë cilitdo vit relevant, Rregullatori mund të bëjë përshtatjet e kostove të zhvlerësimit dhe kthimit të cilat derivohen nga investimet kapitale. Përshtatjet e këtyre kostove mund të bëhen gjatë procesit të përshtatjeve të rregullta apo në periudhën e ardhshme rregullative.
5. Afatet kohore të dorëzimit, plotësimit, si dhe shqyrtimit dhe aprovimit nga Rregullatori i Planit Investiv Njëvjeçar janë dhënë sikurse te Neni 27 i kësaj Rregulle.



## Neni 18

### **Plani Vjetor i Humbjeve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes**

1. Në pajtim me Nenin 28 paragrafi 1.25 të Ligjit për Energjinë Elektrike, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes duhet të përgatisë dhe të paraqes për aprovim te Rregullatori Planin vjetor të humbjeve
2. Plani vjetor i humbjeve duhet të përmbajë:
  - 2.1. Gjendjen aktuale të nivelit të humbjeve teknike dhe komerciale, duke veçuar pikat kritike të sistemit që ndikojnë në nivelin e humbjeve;
  - 2.2. Metodologjinë e planifikuar për zvogëlimin e humbjeve përfshirë aktivitetet në secilin distrikt dhe nivel të tensionit;
  - 2.3. Cakun e parashikuar të humbjeve në pajtim me nivelin e lejuar vjetor të humbjeve të përcaktar nga Rregullatori në Shqyrtimin e Rregullt Tarifor;
  - 2.4. Projektet e parashikuara për zvogëlimin e humbjeve e që janë pjesë e planeve zhvillimore dhe investive;
  - 2.5. Planin kohor të shpërndarë nëpër muaj për nivelin e parashikuar të humbjeve si teknike ashtu edhe ato komerciale.
  - 2.6. Për vitin e parë të periudhës rregullative Plani Investiv Njévjeçar dhe Plani Vjetor i Humbjeve përfshihen në kuadër të procesit të shqyrtimit periodik.

## **KAPITULLI III**

### **ANALIZA E KOST-BENEFITIT (AKB) TË PROJEKTEVE DHE PROGRAMEVE**

## Neni 19

### **Qëllimi dhe qasja në AKB**

1. Në këtë Kapitull, shprehja 'projekt' përdoret për të ju referuar edhe projekteve të mëdha individuale dhe programeve të shumëfishta të projekteve të vogla për të cilat aplikohet AKB.
2. Qëllimi i AKB është që të tregojë se:
  - 2.1 Për projektet diskrecionare, të përcaktuara si ato që nuk ndërmerren për të përmbushur obligimet ligjore, projekti i propozuar ka neto përfitim pozitiv shoqëror dhe se ofron neto përfitimin me të madh pozitiv shoqëror nga cilado alternativ e marrë parasysh;





- 2.2 Për projektet e detyrueshme, të përcaktuara si ato që ndërmerren për të përmbushur obligimet ligjore, projekti i propozuar ka koston më të ulët nga alternativat e marra parasysh.
3. Obligimet ligjore të referuara në paragrafin 2 të këtij Neni janë kërkesat ligjore për të përmbushur standardet ose obligimet specifike mjedisore, sociale, shëndetësore dhe të sigurisë të vendosura në kuadër të marrëveshjeve ndërkombëtare në të cilat Kosova është palë nënshkruese.
  4. Projektet e ndërmarra për të përmbushur detyrimet për lidhje dhe/ose shfrytëzim të projekteve të përcaktuara të energjisë së ripërtëritshme në përputhje me kërkesat ligjore dhe politikat e Qeverisë së Kosovës duhet të konsiderohen si projekte të detyrueshme për qëllimet e nënparagrafit 2.2 të këtij Neni.
  5. Rregullatori ka të drejt, kur të shqyrtoj Planin Pesëvjeçar Investiv të dorëzuar, të përcaktoj që projektet e propozuara për të cilat është ofruar një AKB, të riklasifikohen nga ato diskrecionare në të detyrueshme ose anasjelltas dhe që AKB të rillogaritet në përputhje me rrethanat dhe të dorëzohet përsëri.
  6. Për projektet diskrecionare, AKB krahason Vlerën Neto të Tanishme (VNT) të përfitimeve shoqërore të projektit pa koston totale të projektit nga alternativat e identifikuar.
  7. Për projektet e detyrueshme, AKB krahason vlerën aktuale të koston totale të projektit nga alternativat e identifikuar.
  8. Analiza e duhur e ndjeshmërisë duhet të përfshihet, duke treguar së paku ndikimin e ndryshimeve nga projeksionet bazë në:
    - 8.1 Parashikimet e kërkesës dhe shfrytëzimit të projektit;
    - 8.2 Kontributin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë;
    - 8.3 Datën e komisionimit të projektit.
  9. Kur ndonjë aspekt i këtyre udhëzimeve në lidhje me AKB është i paqartë ose jo i plotë, atëher operatorët e sistemeve duhet t'i referohet udhëzuesve të lëshuara nga ENTSO-E ose ENTSOG - Udhëzime për Analizën e Kost-Benefitit të Projekteve të Zhvillimit të Rrjetit.



## Neni 20

### Vlerësimi i Kostove dhe Përfitimeve

1. Kostot totale të projektit, ashtu siç përdoren në AKB, përfshijnë:
  - 1.1 Investimet kapitale që kërkohen duke përfshirë interesin gjatë ndërtimit dhe kosto tjera financiare dhe duke përjashtuar taksat;
  - 1.2 Një lejim i duhur për kontigjenca fizike dhe të çmimeve;
  - 1.3 Kostot e parashikuara të operimit dhe mirembajtjes gjatë periudhës më të shkurtër të projektit ose periudhës vlerësuese duke përfshirë çdo kosto rehabilitimi ose riparimi kapital;
  - 1.4 Ndonjë ndikim negativ të matshëm mjedisor ose social që rezulton nga projekti, i vlerësuar me gatishmërinë e banorëve të Kosovës që të paguajnë për të shmangur kosto të tilla.
2. Perfitimet totale të projektit, ashtu siç përdoren në AKB, përfshijnë:
  - 2.1 Çdo reduktim në investime kapitale dhe ose kosto të operimit dhe mirëmbajtjes së sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes që rezultojnë nga projekti;
  - 2.2 Çdo reduktim në humbjet e sistemit që rezulton nga projekti, i vlerësuar me koston e parashikuar të blerjes së energjisë me shumicë;
  - 2.3 Çdo reduktim në Neto Energjinë e Shërbyer të parashikuar që rezulton nga projekti, i vlerësuar me Vlerën e Ngarkesës së Humbur (VNH) të aprovuar;
  - 2.4 Çdo reduktim në kosto të energjisë elektrike të furnizuar tek konsumatorët e energjisë elektrike që ndodhen brenda territorit të Kosovës që rezulton nga kufizimet e reduktuara të sistemit ose integrim më të madh të tregut, vlerësuar me kursimin e koston që ka rezultuar;
  - 2.5 Çdo reduktim në kostot e prokurimit ose sigurimit të shërbimeve ndihmëse;
  - 2.6 Çdo përfitim i matshëm pozitiv mjedisor ose social, i cili është i ndryshëm nga reduktimet në Emetimet e Gazrave Serë, që rezultojnë nga projekti, i vlerësuar me gatishmërinë e banorëve të Kosovës për të paguar për përfitime të tilla;
  - 2.7 Çdo reduktim në Emetimet e Gazrave Serë që rezulton nga projekti, i vlerësuar me koston sociale të karbonit ashtu siç është e përcaktuar më poshtë;
  - 2.8 Çdo përfitim tjetër i identifikuar nga i licencuari, se bashku me arsyetimin për përfshirjen e tyre;



2.9 Për alternativat e projektit me  $VNT < 0$ , Rregullatori do të vendosë për nevojën e saj teknike bazuar në kriteret teknike. Në rast të nevojës së projektit(eve), projekti(et) me VNT më të ulët negative do të zgjidhen si më të përshtatshmet.

3. Llogaritjet duhet të bëhen në kushte reale duke përdorur çmimet për vitin në të cilin është dorëzuar Plani Pesëvjeçar Investiv (p.sh., inflacioni nuk do të merret parasysh).
4. Operatorët e Sistemeve mund të bëjnë AKB duke shfrytëzuar Udhëzuesin e Komisionit European për AKB<sup>1</sup>.

#### Neni 21

#### **Kriteret dhe vlerat hyrëse**

1. Rregullatori do të përcaktojë kriteret dhe vlerat hyrëse të mëposhtme jo më vonë se 31 dhjetori i çdo viti.
  - 1.1 Norma e zbritjes (diskontimit) e përdorur për llogaritjen e VNT;
  - 1.2 Periudha për vlerësim;
  - 1.3 Vlera e Ngarkesës së Humbur;
2. Kur asnjë vlerë nuk është përcaktuar, atëher vlejné vlerat më të fundit të përcaktuara.
3. Kur Rregullatori më parë nuk ka përcaktuar vlerën, atëher do të zbatohen vlerat e mëposhtme:
  - 3.1 Norma e zbritjes: Vlera më e fundit e publikuar që do të përdoret për vlerësimin ekonomik nga Qeveria e Kosovë. Atëher kur nuk është publikuar asnjë vlerë, vlera e aplikuar nga ENTSO-E në Udhëzime për Kost-Benefitin të Projekteve të Zhvillimit të Rrjetit do të përdoret;
  - 3.2 Periudha për vlerësimin: nga vitit në të cilin Plani Pesëvjeçar Investiv është dorëzuar deri në 10 vjet pas datës së planifikuar të komisionimit të projektit;
  - 3.3 Vlera e Ngarkesës së Redukuar: Vlerësimet e publikuara për vendet tjera të Komunitetit të Energjisë, me një preferencë në vendet e rajonit të Ballkanit Jug-Perendimor.

---

<sup>1</sup> ([http://ec.europa.eu/regional\\_policy/sources/docgener/studies/pdf/cba\\_guide.pdf](http://ec.europa.eu/regional_policy/sources/docgener/studies/pdf/cba_guide.pdf))



## KAPITULLI IV PRIORITIZIMI I PROJEKTEVE

Neni 22

### **Përzgjedhja e projekteve prioritare**

1. Pas kompletimit të listës së projekteve që do të jenë pjesë e Planit Zhvillimor gjegjësisht Planit Investiv, operatorët e sistemit do të bëjnë përzgjedhjen e projekteve që janë prioritare për zbatim si dhe planin e afat-shkurtë të investimeve për këto projekte.
2. Përzgjedhja e projekteve prioritare për zbatim bëhet duke marrë parasysh disa nga faktorët si më poshtë:
  - 2.1. Obligimet ndërkombëtare që duhet përmbushur (OST, OSTGN);
  - 2.2. Obligimet ligjore që kanë operatorët e sistemit;
  - 2.3. Rritjen e sigurisë së furnizimit dhe qëndrueshmërisë së sistemit;
  - 2.4. Eliminimin e pengesave teknike në sistem që kanë për pasojë mungesën apo reduktimet e energjisë për konsumatorë;
  - 2.5. Zvogëlimin e humbjeve;
  - 2.6. Përmbushjen e kërkesave në rritje për kyqje në sistem, sidomos të BRE-ve dhe konsumatorëve – vetëprodhues.
3. Klasifikimi i projekteve duhet të bazohet në:
  - 3.1 Domosdoshmërinë teknike të projektit ose programit për t'u zbatuar sipas faktorëve të paragrafit 2 të këtij Neni;
  - 3.2 Neto përfitimi i projektit ose programit ashtu siç është llogaritur nga AKB (atëher kur është e aplikueshme);
  - 3.3 Niveli i rreziqeve që lidhen me zbatimin e projektit ose programit, me projekte dhe programe me rreziqe të ulëta që janë caktuar me prioritet më të lartë;
  - 3.4 Faktorë tjerë që operatori i sistemit i vlerëson si relevante.



#### Neni 23

##### **Kostoja dhe afati kohor për zbatimin e Planeve Zhvillimore dhe Investive**

1. Pas përgatitjes së listës së projekteve që do të vendosen në Planet Zhvillimore dhe Investive, Operatorët e Sistemeve do të paraqesin koston dhe afatin kohor të zbatimit të secilit projekt në veçanti dhe koston dhe afatin kohor të zbatimit të Planeve Zhvillimore dhe Investive në përgjithësi.
2. Kostoja e projekteve që planifikohet të zbatohen duhet të jetë transparente, e thjeshtë për ta kuptuar dhe në harmoni me çmimet e tregut.
3. Plani kohor dhe kostoja duhet përfshijë tabela përmbledhëse me të gjitha projektet e identifikuara, fazat kryesore të tyre, dinamikën dhe afatet kohore për zbatim, mënyrën e financimit të projekteve.
4. Afatet kohore për zbatimin e projekteve nga Planet Zhvillimore dhe Investive duhet të jenë reale dhe të njohura për konsumatorët dhe publikun.

#### Neni 24

##### **Projektet Kapitale tjera që janë të domosdoshme për operim normal të Operatorëve të Sistemeve**

1. Të gjitha projektet kapitale që nevojiten për operim normal të Operatorëve të Sistemeve duhet të parashihen në Planet Zhvillimore dhe në Planet Investive.
2. Projektet kapitale duhet të arsyetohen dhe të tregojnë se si do t'i kontribuojnë realizimit të objektivave të planeve zhvillimore dhe planeve investive.
3. Operatorët e Sistemeve duhet që të paraqesin kostot e projekteve kapitale operative, si dhe përfitimet e mundëshme nga këto projekte në operimin eficient të operatorëve.
4. Projektet kapitale për modernizim të IT, logjistikës operative duhet të jenë në funksion të sigurisë së operimit të sistemit.
5. Operatorët e Sistemit duhet të vlerësojnë rreziqet dhe pasojat që mund të paraqiten në rast të moszbatimit të projekteve kapitale për operim normal të sistemeve.



## **KAPITULLI V**

### **PROCESI I DORËZIMIT DHE VLERËSIMIT TË PLANEVE ZHVILLIMORE**

#### Neni 25

#### **Dorëzimi, Rishikimi dhe Aprovimi i Planeve Zhvillimore**

1. Dorëzimi i Planeve Zhvillimore është i definuar në Nenin 11 të kësaj Rregulle.
2. Operatori i Sistemit dorëzon te Rregullatori Planin Zhvillimor jo më vonë se 15 korrik te vitit aktual.
3. Deri me 05 shtator, Rregullatori do të kërkohet informata apo të dhëna shtesë në lidhje me planin e paraqitur nga Operatori i Sistemit.
4. Deri me 31 tetor, Operatori do të dorëzoj planin e kompletuar sipas kërkesave të Rregullatorit.
5. Deri me 1 nëntor, rregullatori mund të kërkojë ndonjë të dhënë shtesë për PZH.
6. Deri me 15 nëntor, Operatori i Sistemit dorëzon të dhënat shtesë të kërkuara nga Rregullatori.
7. Deri me 31 dhjetor, Rregullatori duhet ta aprovoj Planet Zhvillimore.
8. Ky cikël përsëritet për Planet Zhvillimore vijuese të përditësuara, me përjashtim të afateve të përcaktuara në nenin 26 të kësaj rregulle.
9. Në kohën kur viti i dërgimit të Planeve Zhvillimore koïncidon me Periudhën Rregullative, procesi dhe orari i Planeve Zhvillimore duhet të jetë i njëjtë me atë të Periudhës Rregullative.

#### Neni 26

#### **Dorëzimi i Planeve Investive për Periudhë Rregullative**

1. Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes duhet dërgojnë në ZRRE për aprovim Planet Investive për çdo periudhë rregullative. Orari indikativ i përshkruar në paragrafët e mëposhtëm të këtij neni vlenë për periudhë rregullative.
2. Gjatë shqyrtimit periodik për periudhë rregullative, Plani Investiv i Transmetimit dhe Plani Investiv i Shpërndarjes duhet të jenë në harmoni me këtë afat kohor.
3. Operatorët e Sistemit dorëzojnë te Rregullatori një Plan Preliminar Investiv jo më vonë se 15 marsi i vitit që i paraprin Shqyrtimin Periodik. Përmbajtja e Planit Investiv është specifikuar në Nenin 15 të kësaj rregulle .
4. Deri me 5 maj të të njëjtit vit, Rregullatori do të identifikojë informatat apo të dhënat shtesë te nevojshme për të kompletuar shqyrtimin e Planeve.



5. Deri me 1 qershor të të njëjtit vit, Operatorët e Sistemeve do të dorëzojnë te Rregullatori Planet Investive duke marrë parasysh informatat apo të dhënat shtesë të kërkuara nga Rregullatori pas shqyrtimit preliminar.
6. Deri më 15 gusht të të njëjtit vit, Rregullatori do të identifikoj çdo informatë shtesë apo të dhënë që kërkoet për përfundimin e shqyrtimit të vetë të Planeve Investive të dorëzuara nga operatorët. Operatorët e Sistemeve duhet të dorëzojnë çdo informatë ose të dhënë të tillë shtesë të identifikuar deri me 31 gusht të të njëjtit vit.
7. Rregullatori mund t'u kërkojë të licencuarve te prezantojnë Planet Investive në një seance publike si pjesë e procesit të vlerësimit.
8. Planet Investive duhet të jenë në harmoni me planet zhvillimore dhjetëvjeçare të operatorëve të rrjetit.
9. Një përmbledhje e Planit Investiv të OST-së dhe të OSSH-së do të publikohet në faqen elektronike zyrtare te Rregullatorit. Informatat konfidenciale mund te redaktohen ne përmbledhjen e publikuar.

#### Neni 27

##### **Dorëzimi i Planeve Investive Njëvjeçare (PINJV) të OSSH-së**

1. Orari i dorëzimit të Planeve Investive Njëvjeçare nga OSSH-ja, si dhe i rishikim dhe aprovimit rregullator të këtyre planeve është i njëjtë me orarin e dorëzimit, rishikimit dhe aprovimit rregullator të Planeve Zhvillimore Pesëvjeçare të OSSH-së.
2. Projektet e përfshira në Planet Investive Njëvjeçare duhet të jenë gjithashtu të paraqitura në Planet Zhvillimore Pesëvjeçare të OSSH-së.

#### Neni 28

##### **Lista kontrolluese për vlerësim rregullator**

1. Pas dorëzimit të Planeve Zhvillimore dhe Investive, Rregullatori do të vlerësoj metodologjinë dhe modelet e përdorura nga operatorët e sistemit në përgatitjen e këtyre planeve. Fokusi i Rregullatorit duhet të jetë në këto fusha:
  - 1.1. Përshkrimi i standardeve të përdorura për planifikim;
  - 1.2. Analizimi i skenareve të planifikuara;
  - 1.3. Rezultatet e studimeve teknike;
  - 1.4. Përshkrimi i përshtatshëm i parametrave drejtues (promotor) në përgatitjen e planeve;



- 1.5. Parashikimet e paramentrave kryesor të pasigurisë për vite të caktuara;
- 1.6. Rezultatet e AKB për projekte të mëdha;
- 1.7. Skenaret e preferuara të operatorëve të sistemit;
- 1.8. Identifikimn e parametrave kritik dhe vlerat kaluese si rezultat i analizës së ndjeshmërisë, analizës së rrezikut si masa të përshtatshme të parandalimit –ose zbutjes.

#### Neni 29

#### **Vlerësimi rregullator në bazë të parashikimit të kërkesës**

1. Gjatë vlerësimit të Planeve Zhvillimore dhe Investive, Rregullatori duhet të vlerësoj se si janë bërë planifikimet e syzozuara për kërkesën për energji, me fokus në këto fusha:
  - 1.1. Parashikimet e kërkesës për energji për periudhën e caktuar, me skenarët që marrin parasysh faktorët që ndikojnë në kërkesën për energji (GDP, karakteristikat e sektorit ekonomik në lidhje me kërkesën për energji).
  - 1.2. Parashikimet për ngarkesa maksimale (pikut) për periudhën e caktuar, duke marrë parasysh temperaturat dhe menaxhimin e anës së kërkesës (Demand Side Management).
  - 1.3. Parashikimet e furnizimit, marrë parasysh adekuacinë e gjenerimit, fleksibilitetin, varësia nga importi dhe stabilitetin ekonomik.
  - 1.4. Zhvillimet rajonale dhe globale sa i përket kërkesës për energji.

#### Neni 30

#### **Kategorizimi dhe rishikimi i projekteve**

1. Për një vlerësim sa më të mirë të projekteve që janë pjesë e Planeve Zhvillimore dhe Investive preferohet që të bëhet kategorizimi i tyre. Secila kategori e projekteve do të ketë kritere të ndryshme të vlerësimit me peshë të ndryshme për vlerësim.
2. Projektet e operatorëve të sistemit preferohet që të kategorizohen në këto kategori të veçanta, marrë parasysh objektivat e tyre:
  - 2.1. Qëndrueshmëria: siguria e furnizimit, besueshmëria dhe siguria e operimit;
  - 2.2. Zgjerimi eficientë: Përbushja e kërkesës në rritje për energji me humbje minimale në rrjet;
  - 2.3. Funkcionimi i Tregut të energjisë elektrike dhe gazit natyror: Eliminimi i pengesave të mbrendëshme (fytet e ngushta) apo integrimi në tregun rajonal;





2.4. Dhënja e qasjes: Përbushja e nevojave për gjenerim dhe për kërkesë.

2.5. Të planifikuara strategjikisht: Përbushja e qëllimeve nacionale.

#### Neni 31

##### **Projektet në kategorinë e qëndrueshmërisë – kriteret për vlerësim**

1. Zbatimi i projekteve në kategorinë e qëndrueshmërisë do të rezultojë me rritjen e normave të besueshmërisë dhe sigurisë së furnizimit dhe do të kontribuojnë në zvogëlimin e Energjisë të Pafurnizuar (ENS) dhe në zvogëlimin e kohëzgjatjes së ndërprejeve të furnizimit me energji (AIT)
2. Kriteret për vlerësim të projekteve të kësaj kategorie do të jenë:
  - 2.1. Zvogëlimi i **EEP** në bazë vjetore, dhe
  - 2.2. Zvogëlimi i KMNFE, gjithashtu në bazë vjetore.

#### Neni 32

##### **Projektet në kategorinë e zgjerimit eficientë – kriteri për vlerësim**

1. Zbatimi i projekteve në kategorinë e zgjerimit eficientë do të rezultojë me rritjen e aftësisë së sistemeve për përbushjen e kërkesës në rritje, si dhe për integrimin e BRE-ve në sistem. Gjithashtu do të kontribuojnë në zvogëlimin e humbjeve në sistem.
2. Kriter për vlerësim të projekteve të kësaj kategori do të jetë: Zvogëlimi i Humbjeve, opsionet për investime në rehabilitim apo zëvendësim të aseteve.

#### Neni 33

##### **Projektet në kategorinë e funksionalizimit të tregut të energjisë - kriteri për vlerësim**

1. Zbatimi i projekteve në kategorinë e funksionalizimit të tregut të energjisë do të rezultojë me rritjen e aftësisë së sistemit për të zvogëluar kongestionet, rritjen e aftësisë së rrjetit për bartjen e energjisë (KTR), rritjen e numrit të njehsorëve intervali të vendosur te konsumatorët, si dhe rritjen e mundësive për tregëtim të energjisë.
2. Kriter për vlerësimin e projekteve të kësaj kategorie është kapaciteti i rrjetit për bartjen e energjisë (KTR) në MW kapacitet transmetues dhe shpërndarës dhe numri i konsumatorëve që i kanë mundësitë teknike për pjesëmarrje në treg.



#### Neni 34

##### **Projektet në kategorinë e dhënjes së qasjes në sistem - kriteri për vlerësim**

1. Zbatimi i projekteve nga kjo kategori do të rezultoi me rritjen e kapaciteteve për t'u përgjigjur kërkesave në rritje për kyqje në sistem të gjeneratorëve, gjeneratorëve nga BRE-et, Konsumatorëve vetë-prodhues dhe konsumatorëve më kërkesë të madhe për energji.
2. Kriter për vlerësimin e projekteve të kësaj kategorie është: Rritja e kapacitetit të rrjetit në MW.

#### Neni 35

##### **Projektet në kategorinë e planifikimeve strategjike - kriteri për vlerësim**

1. Projektet tjera, implementimi i të cilave është favorizuar nga strategjia kombëtare e energjisë, dmth. Strategjia e planifikuar, kontrolli i sistemit dhe mbledhja e të dhënave (SCADA), softueri për mbikëqyrjen e sistemit, instalimet optike tokësore (OPGW), siguria kibernetike, megjithatë, shpenzimet kapitale për ndërtimin e këtyre projekteve nuk duhet të jetë e tepruarara dhe mund të kërkohet nxitje përkatëse ose zbatim gradual të këtyre projekteve.
2. Për vlerësimin e këtyre projekteve do të zbatohet analiza me shumë kriterë, përfshirë rritjen e sigurisë së sistemeve, koston e zbatimit, gatishmërinë e sistemeve për integritet rajonale dhe europiane.

#### Neni 36

##### **Kushtet e përgjithëshme që duhet të plotësojë secili projekt i përzgjedhur për Planet Zhvillimore**

1. Projektet e përzgjedhura si pjesë e Planeve Zhvillimore e që kanë të bëjnë me ndërtime/instalime të reja duhet të pajisen me të gjitha lejet që kërkohen në legjislacionin vendor.
2. Marrja e lejeve, sidomos për projekte të mëdha mund të merrë shumë kohë dhe për këtë operatorët e sistemit duhet të jenë të përgatitur.
3. Secili projekt i madh duhet të ketë këto faza të zbatimit:
  - 3.1. Studimin e parafizibilitetit dhe fizibilitetit, përfshirë atë teknik dhe socio-ekonomik;
  - 3.2. Studimin mjedisor dhe hapsinor;
  - 3.3. Paraqitjen e opsioneve alternative;
  - 3.4. Konsultimet publike;
  - 3.5. Përgatitjen e dokumentacionit për leje, kontrata dhe dokumente tjera;



- 3.6. Negocimi dhe sigurimi i qasjes në toka të pronarëve (nëse është e nevojshme);
  - 3.7. Projekti detal teknik;
  - 3.8. Tenderimi;
  - 3.9. Punët përgatitore për ndërtim;
  - 3.10. Ndërtim; dhe
  - 3.11. Komisionimi
4. Projektet e përzgjedhura si pjesë e planeve zhvillimore duhet të jenë të harmonizuara me projektet e operatorëve tjerë dhe të institucioneve tjera relevante të sektorit si, ministritë komunat dhe agjencionet.

#### Neni 37

##### **Analizat e parafizibilitetit dhe përshkrimi teknik**

1. Planet Zhvillimore duhet të kenë një analizë që është bërë në fazën e parafizibilitetit që arsyeton zbatimin e projekteve, përcjellë më arsyetimet teknike si në vijim:
  - 1.1. Ndikimin mjedisor dhe qëndrueshmëria e projekteve;
  - 1.2. Qëllimi dhe kategoria e projekteve;
  - 1.3. Identifikimi i përfitimeve sasiore;
  - 1.4. Përshkrimi teknik, duke përfshirë parashikimin e kërkesës dhe përshkrimin e punës dhe ndikimin e tyre të pritshëm.

#### Neni 38

##### **Kostot e projekteve**

1. Analizimi i kostove të projekteve në veçanti dhe analizimi i kostove të Planeve Zhvillimore në përgjithësi bëhet nga Rregullatori.
2. Kostot e paraqitura nga Operatorët e Sistemeve duhet të jenë të arsyeshme, të krahasueshme dhe në pajtim me çmimet e tregut.
3. Për vlerësimin e projekteve kapitale, adaptimi i një liste të çmimeve për njësi për kategori të ndryshme të infrastrukturës që do të ndërtohet, instalohet apo ndërrohet do të ishte e preferueshme, sipas formularëve të zhvilluar nga ZRRE.



4. Çmimet për njësi mund të nxirren duke u bazuar në:
  - 4.1. Të dhënat historike për çmimet e infrastrukturës të projekteve të përfunduara
  - 4.2. Çmimet aktuale të tregut;
  - 4.3. Krahasimeve (Benchmarks) të bëra në vend;
  - 4.4. Krahasimet rajonale dhe ndërkombëtare; dhe
  - 4.5. Çmimet e tokës dhe punës që mund të jenë të ndryshme për vende të ndryshme.
5. Krahasimet (benchmarks) e çmimeve për materiale të ndryshme mund të zhvillohen nga të dhënat aktuale (post – zbatuese) për së paku disa nga elementet e rëndësishme të infrastrukturës:
  - 5.1. Ndërrimin e pajisjeve të rjetit apo përforcimi i nënstacioneve (për kapacitet)
  - 5.2. Ndërrimin e transformatorëve për t'a rritur kapacitetin e tyre (për madhësi)
  - 5.3. Ndërtimin e linjave të reja të transmisionit apo shpërndarjes, të nënstacioneve (për madhësi, gjatësi dhe kapacitet).

#### Neni 39

#### **Lista e vlerësimit rregullator të anës teknike dhe të kostove të Planeve Zhvillimore dhe Investive**

1. Rregullatori duhet të vlerësoj informatat teknike dhe financiare të paraqitura nga operatorët e sistemit në planet zhvillimore dhe fushat e rëndësishme për vlerësimin sistematik janë:
  - 1.1. Dëshmitë për ndikimet mjedisore dhe qëndrueshmëria e projekteve, ashtu siq kërkohet me Ligjet dhe Rregullat në fuqi;
  - 1.2. Shpërndarja e ballancuar e projekteve sipas 5 kategorive të identifikuara sipas Nenit 30 të kësaj Rregulle;
  - 1.3. Vlerësimet për ENS dhe AIT për projektet në kategorinë e qëndrueshmërisë;
  - 1.4. Vlerësimet e rritjes së kapaciteteve për secilin projekt që ka për qëllim dhënjen e qasjes në system;
  - 1.5. Prezentimin e domosdoshmërisë dhe prioriteve për projektet strategjike;
  - 1.6. Statusi i të gjitha obligimeve ligjore, rregullatore dhe të lejeve të nevojshme për zbatimin e projekteve;
  - 1.7. Përshkrimi adekuat teknik dhe arsyeshmëria e projekteve;



- 1.8. Kostot e arsyeshme për ndërrimin e linjave ajrore apo nëntoksore dhe përforcimeve;
- 1.9. Kostot e arsyeshme për ndërrimin e gypave;
- 1.10. Kostot e arsyeshme për pajisjet e përforcimit të rrjetit (energjisë elektrike, energjisë termike dhe gazit natyror);
- 1.11. Kostot e arsyeshme për ndërrimin e transformatorëve;
- 1.12. Kostot e arsyeshme për ndërrimin e nënstacioneve të energjisë termike (këmbyesve) dhe gazit natyror;
- 1.13. Kostot e arsyeshme për ndërtimin e linjave të reja transmetuese dhe shpërndarëse dhe nënstacioneve;
- 1.14. Kostot e arsyeshme për ndërrimin/vendosjen e pajisjeve matëse.

#### Neni 40

##### **Vlerësimet e Kostove për njësi**

1. Vlerësimet e kostove të përdorura nga Operatorët e Sistemit duhet të janë të arsyeshme dhe në përputhje me standardet (benchmarks) e disponueshme të kostove për njësi.
2. Duke i'u referuar vlerave paraprake të kostove për njësi për projektet e përfunduara, vlerave aktuale të tregut, si dhe në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, operatorët e sistemit duhet që të paraqesin kostot për njësi për kategori të ndryshme të pajisjeve sipas formularëve të zhvilluar nga ZRRE.

#### Neni 41

##### **Vlerësimi i Rrezikut për projekte**

1. Vlerësimi i rrezikut duhet të bëhet për të gjitha projektet për të cilat bëhet AKB.
2. Rregullatori mbanë të drejtën që për projekte të caktuara me karakterisika të veçanta të kërkoj nga operatorët e sistemit që të bëhet vlerësimi i rrezikut edhe pse për ato projekte nuk bëhet AKB për shkak të madhësisë.
3. Vlerësimi i rrezikut do t'u mundësoi operatorëve të sistemit që të bëjnë krahasimin e projekteve që kanë objektiva të njejta dhe janë konkures, si dhe të bëjnë prioritizimin e tyre.
4. Vlerësimi i rrezikut do të tregojë hapat që duhet të ndërmerren në mënyrë që të shmangen rreziqet dhe do të identifikoi masat që duhet të ndërmerren për zbutjen e pasojave të rreziqeve.



5. Një prej metodave për vlerësimin e rrezikut që operatorët e sistemit mund ta shfrytëzojnë është Udhëzuesi i Komisionit Evropian ashtu siq i'u është në nenin 20, paragrafi 4 i kësaj Rregulle.
6. Vlerësimi i Rrezikut duhet të përmbajë këto elemente:
  - 6.1. Analiza e ndjeshmërisë (sasiore) synon të vlerësojë ndjeshmërinë dhe qëndrueshmërinë e një projekti ndaj ndryshimeve të mundshme në variablat hyrëse të AKB, si ato pozitive dhe negative
  - 6.2. Analiza e rrezikut (cilësore) synon të vlerësojë rreziqet më të gjëra ndaj të cilave ekspozohet një projekt, si dhe çdo veprim për eliminimin/zbutjen e tyre dhe ndikimin e tyre. Analiza e rrezikut është cilësore dhe synon të identifikoi dhe vlerësojë rreziqet që lidhen me një projekt duke përfshirë, por pa u kufizuar në faktorët e analizuar si pjesë e analizës së ndjeshmërisë;
  - 6.3. Masat për zbutjen dhe parandalimi i rrezikut, paraqesin veprime që duhet ndërmarrë për të zvogëluar apo eliminuar pasojat nga rreziqet.
  - 6.4. Analiza e probabilitetit të rrezikut kërkohet kur ekspozimi ndaj rrezikut të mbetur është ende i rëndësishëm, në mënyrë që të kemi informacion të plotë për profilin e rrezikut të një projekti.

## Neni 42

### **Vlerësimi Rregullator i Vlerësimin të Rreziqeve nga operatorët e sistemit**

1. Rregullatori do të vlerësojë metodologjinë e përdorur nga Operatorët e Sistemit për projektet për të cilat kërkohet vlerësimi i rreziqeve. Lista kontrolluese për vlerësim rregullator duhet të përcaktojë se:
  - 1.1. Variablat janë testuar në mënyrë deterministike të pavarura (psh. nuk karakterizohen nga një marrëdhënie e saktë) dhe janë të ndara sa më shumë që është e mundur;
  - 1.2. Janë analizuar të gjitha variablat e pavarur të projektit dhe se janë identifikuar qartë variablat kritikë dhe vlerat e ndërrimit;
  - 1.3. Kriteri i përdorur është i përshtatshëm për identifikimin e variablave kritikë;
  - 1.4. Lista e rreziqeve të listuara është e mjaftueshme, duke përfshirë edhe rreziqet që janë jashtë kontrollit të promovuesit të projektit ose palëve të tjera të interesuara (psh. ndryshimi i legjisllacionit);
  - 1.5. Janë identifikuar në mënyrë adekuate shkaqet dhe ndikimet/efektet e rrezikut dhe se janë diskutuar në detaje të mjaftueshme me të gjitha palët;
  - 1.6. Janë identifikuar masa parandaluese/zbutëse për të gjitha rreziqet dhe se masat e identifikuar janë të përshtatshme për sa i përket efektivitetit dhe kohës dhe se intensiteti i tyre është në përpjesëtim me nivelin e rrezikut;



- 1.7. Eshtë kryer një analizë probabilitike e rrezikut, në rastet kur pas identifikimit të të gjitha masave të mundshme parandaluese/zbutëse mbetet një rrezik i konsiderueshëm i mbetur;
- 1.8. Përcakton ndonjë masë rregullative për zbutjen e rrezikut që Rregullatori mund të ndërmarrë;

## **KAPITULLI VI**

### **PËRCAKTIMI I REZULTATEVE - RAPORTIMI I PERFORMANCËS**

Neni 43

#### **Përcaktimi i Rezultateve**

1. Si pjesë e Planeve Zhvillimore të dorëzuara, përfshirë planet investive të parapara, Operatorët e Sistemeve (të licencuarit) do të dorëzojnë një sërë rezultatesh të propozuara për monitorimin e arritjes së përfitimeve të pritshme nga plani i investimeve.
2. Këto rezultate duhet të kenë përcaktim sasior dhe të jenë të verifikueshme nga të dhënat e publikuara ose nga të dhënat e mbledhura nga i licencuari.
3. Rezultatet duhet të përfshijnë masat e besueshmërisë, sigurisë dhe cilësisë së sistemit të të licencuarit si dhe rezultate të tilla që mund të konsiderohen si të përshtatshme. Në minimum, rezultatet duhet të përfshijnë:
  - 3.1 Frekuencën dhe kohëzgjatjen e defekteve në sistem;
  - 3.2 Energjinë që nuk është shërbyer si rezultat i mungesës së infrastrukturës të të licencuarit;
  - 3.3 Nivelin e humbjeve të energjisë në sistem;
  - 3.4 Gjendja e aseteve të sistemit.
4. Për secilin rezultat, i licencuari duhet të definoj në Planin Pesëvjeçar Investiv të dorëzuar:
  - 4.1 Një vlerë bazë, që përfaqëson performancën aktuale;
  - 4.2 Vlerën e synuar në përfundim të periudhës së ardhshme rregullative nëse zbatohet Planin Pesëvjeçar Investiv i dorëzuar;
  - 4.3 Vlerën e parashikuar në përfundim të periudhës së ardhshme rregullative nëse nuk zbatohet Planin Pesëvjeçar Investiv i dorëzuar;



- 4.4 Një shpjegim se si janë nxjerrë këto synime dhe vlera të parashikuara;
- 4.5 Një përshkrim se si mund të matet dhe verifikohet performanca për secilin rezultat
5. Bazuar në vlerësimin e rezultateve të paraqitura nga operatori i sistemit, politikave zhvillimore të sektorit, kërkesave ligjore dhe rregullatore, Rregullatori mund të kërkojë nga operatori i sitemit që të:
  - 5.1 Bëjë ndryshimin e projekteve të propozuar me projekte tjera, gjegjësisht të ofron opsione tjera më të favorshme ;
  - 5.2 Shtojë projekte;
  - 5.3 Bëjë simulime softueurike për të vlerësuar arsyeshmërinë e projekteve.
6. Nëse disa nga projektet e propozuara nga operatori i sistemit nuk janë në pajtim me politikat zhvillimore të sektorit, kërkesat ligjore dhe rregullatore dhe rezultatet e pritshme, atëher rregullatori ka të drejtë refuzimin e tyre.

#### Neni 44

#### **Raportimi i Performancës**

1. Para përfundimit të secilës periudhë rregullative, i licencuari duhet të raportojë mbi performancën aktuale kundrejt secilit rezultat në raport me atë të projektuar në Planet Zhvillimore apo Investive.
2. Rregullatori do të marrë parasysh dallimet në mes të performancës aktuale dhe performancës së parashikuar në dhënien e rezultateve në:
  - 2.1 Vlerësimin e arsyeshmërisë, arsyetimin dhe rreziqet që lidhen me projektet dhe programet e propozuara të përfshira në Planin Investiv të dorëzuar në periudhën e ardhshme;
  - 2.2 Përcaktimin nëse do të aplikohet ndonjë kthim i kostove ose ndryshim tjetër në të hyrat e lejuara në kuadër të periudhës së ardhshme për shkak të ndonjë dështimi për të përfunduar programin e miratuar të investimeve për periudhën aktuale.
3. Operatorët e sitemit duhet të raportojnë në baza vjetore për performancën e realizimit të projekteve të planeve zhvillimore dhe të atyre investive dhe të paraqesin:
  - 1.1 Listen e projekteve te planifikuara;
  - 1.2 Listen e projekteve të realizuara;
  - 1.3 Përparimin në % të projekteve të filluara e qe kanë kohëzgjatje edhe në vitet pasuese;
  - 1.4 Listen e projekteve të porealizuara, me arsytet për mosfillimin apo për mosrealizimin e tyre;
  - 1.5 Koston e projekteve të planifikuara dhe të realizuara;





1.6 Rezultatet e arritura të secilit projekt të realizuar.

4. Në zbatimin e projekteve të planeve zhvillimore, gjegjësisht planeve investive, operatorët e sistemeve duhet të paraqesin dhe raportojnë në baza vjetore për burimet e financave për realizimin e këtyre projekteve (burime vetanake, grant apo kredi)

## KAPITULLI VII

### NDRYSHIMI/PLOTËSIMI I PROJEKTEVE TË APROVUARA NË PLANET ZHVILLIMORE DHE INVESTIVE

Neni 45

#### **Moszbatimi i projekteve të aprovuara**

1. Nëse operatorët e sistemeve nuk i zbatojnë projektet e planeve zhvillimore gjegjësisht investive, të aprovuara nga Rregullatori, atëherë ata duhet të japin arsyet për moszbatimin e tyre e të cilat mund të jenë:
  - 1.1. Ndryshim i politikave dhe strategjisë zhvillimore të shtetit;
  - 1.2. Mungesë e financave për zbatimin e projekteve;
  - 1.3. Vlerësimi se zbatimi i projektit është me rrezikshmëri të lartë;
  - 1.4. Ndryshim i rrethanave që ndikojnë në AKB;
  - 1.5. Forcë madhore;
  - 1.6. Ndonjë arsye tjetër të cilën duhet t'a japin operatorët.

Neni 46

#### **Njoftimi për Rregullatorin për moszbatimin e projekteve të aprovuara**

1. Për moszbatimin e projektit/ve të aprovuar në planet zhvillimore dhe investive, operatorët e sistemeve duhet t'a njoftojnë Rregullatorin për arsyet e moszbatimit.
2. Njoftimi për moszbatimin e projektit/ve duhet të bëhet jo më vonë se 3 muaj para datës kur është planifikuar fillimi i zbatimit të projektit.
3. Në njoftimin për moszbatim të projektit duhet të paraqitet edhe kostoja e parashikuar e zbatimit si dhe ndikimi i moszbatimit të projektit në arritjen e rezultateve të caktuar në planet zhvillimore dhe investive.



4. Operatori i Sistemit duhet të paraqesë masat që do të ndërmerren për të zvogëluar pasojat nga moszbatimi i projektit.

#### Neni 47

#### **Zbatimi i projekteve që nuk janë në planet zhvillimore dhe investive dhe nuk janë të aprovuara nga Rregullatori**

1. Operatori i Sistemit nuk mund të zbatojë projekte të cilat nuk janë paraparë në planet zhvillimore dhe investive, e të cilat janë të aprovuara nga Rregullatori.
2. Nëse Operatori i Sistemit e zëvendëson një projekt kapital në planin e aprovuar të investimit me një projekt alternativ para se të marrë aprovimin e rregullatorit, rregullatori do ta marrë në konsideratë nëse do ta aprovojë ose jo zëvendësimin në shqyrtimin periodik pasues por nuk është i obliguar ta bëjë këtë.
3. Nëse egzistojnë arsye për zbatimin e ndonjë projekti që nuk është në planet zhvillimore dhe investive, atëherë Operatori i Sistemit duhet që paraprakisht të njoftoi Rregullatorin.
4. Kërkesën për aprovimin e projektit që nuk është në planet zhvillimore dhe investive, Operatori i Sistemit do t'a paraqesë te Rregullatori së paku tre muaj para fillimit të zbatimit të projektit.
5. Rregullatori do të shqyrtojë kërkesën e operatorit të sistemit dhe do të vendosë për aprovimin apo refuzimin e projektit/ve të paraqitura, jo më vonë se 45 ditë nga data e paraqitjes së kërkesës nga operatori i sistemit.
6. Rregullatori mund të kërkojë nga operatori i sistemit të dhëna dhe informata shtesë në lidhje me projektin/et e propozuara. Afati prej 45 ditëve për vendosjen nga Rregullatori në lidhje me projektin/et, do të rrjedhë nga data e kompletimit të dokumentacionit nga operatori i sistemit.
7. Projektet e reja të propozuara duhet të jenë në pajtim me ato objektiva dhe rezultate të përcaktuara për planet zhvillimore dhe investive.



## **KAPITULLI VIII OBLIGIMET E RREGULLATORIT**

### Neni 48

#### **Konsultimet me palët e interesit**

1. Konsultimet me palët e interesit janë të përcaktuara në Neni 10 paragrafët 4 dhe 5 të Ligjit për Energjinë, dhe në Nenin 27 të Ligjit për rregullatorin e Energjisë, ku përcaktohen detyrat e Rregullatorit në lidhje me interesin e palëve dhe konsultimeve.

### Neni 49

#### **Monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të planeve**

1. Monitorimi dhe zbatimi i projekteve nga Operatorët e Sistemeve është definuar në Nenin 10 paragrafët 6,7,8,9,10 dhe 11 të Ligjit për Energjinë, si në vijim:
  - 1.1 Rregullatori i monitoron dhe vlerëson zbatimin e planeve zhvillimore dhe investive të rrjetit.
    - 1.1 Në rastet kur Operatori i Sistemit të Transmetimit, për arsye tjera nga ato që janë jashtë kontrollit të saj, nuk e ekzekuton një investim, i cili, sipas planit dhjetë (10) vjeçar të zhvillimit të rrjetit është dashur të ekzekutohet në tre (3) vjetët e ardhshme, Rregullatori obligohet të merr së paku një nga masat në vijim për të siguruar që investimi në fjalë është bërë nëse ai investim është ende relevant në bazë të planit të mëvonshëm dhjetë (10) vjeçar për zhvillimin e rrjetit:
      - 1.1.1 të kërkojë që Operatori i Sistemit të Transmetimit të ekzekutojë investimet në fjalë;
      - 1.1.2 të organizojë një procedurë të tenderimit të hapur për çdo investitor për investimet në fjalë; apo
      - 1.1.3 të obligojë Operatorin e Sistemit të Transmetimit që ta pranojë një rritje të kapitalit për ta financuar investimin e nevojshëm dhe për t'i lejuar investitorët e pavarur që të marrin pjesë në kapital.
  2. Në rastet kur Rregullatori i ka përdorur kompetencat e tij sipas paragrafit 1.2 të këtij neni, mund ta obligojë operatorin e sistemit të transmetimit që të pajtohet për njërën apo më shumë nga këto investime si në vijim:
    - 2.1 financimin nga pala e tretë;
    - 2.2 ndërtimin nga pala e tretë;
    - 2.3 vetëndërtimin e aseteve të reja në fjalë;



2.4 vetëoperimin e aseteve të reja në fjalë.

3. Operatori i Sistemit të Transmetimit iu siguron investitorëve të gjitha informatat e nevojshme për realizimin e investimit, i lidh asetet e reja me rrjetin e transmetimit për ta lehtësuar zbatimin e projektit të investimit. Aranzhimet relevante financiare i nënshtrohen për miratim Rregullatorit.
4. Në rastet kur Rregullatori i ka përdorur kompetencat e veta sipas nënparagrafit 2.1 të këtij Neni, rregullimet relevante të tarifave e mbulojnë koston e investimeve në fjalë.
5. Planet zhvillimore të përgatitura nga operatorët e energjisë duhet të jenë në pajtim me Strategjinë dhe me programin e zbatimit të Strategjisë dhe duhet të publikohen ne ueb-faqen e Rregullatorit.
6. Nga operatorët mund të kërkohet raporti i monitorimit të zbatimit të planeve investive në baza vjetore me detajet e analizës që tregojnë progresin e projektit, ndikimet e projektit, arsyetimet e mundshme për vonesa, kostot e planifikuara dhe të zbatuara.
7. Operatorët do të raportojnë pas përfundimit të projekteve të realizuara dhe të komisionuara. Raportimi përfshin një listë me të dhënat e projekteve të realizuara të cilat kanë ndikim direkt ose indirekt në komunitet, të gjendjes paraprake dhe pas komisionimit me të dhënat e kërkuara sipas nenit 5 të kësaj Rregulle.

Neni 50

#### **Pajtueshmëria dhe Publikimi i Planeve Zhvillimore**

Planet zhvillimore të përgatitura nga operatorët e energjisë duhet të jenë në pajtim me Strategjinë e Energjisë dhe me programin e zbatimit të Strategjisë dhe duhet të publikohen ne ueb-faqen e Rregullatorit.

Neni 51

#### **Informata shtesë**

Gjatë të gjitha fazave, nga operatorët, Rregullatori mund të kërkojë të dhëna shtesë, simulime, qasje në aplikacione, përgatitje të skenareve tjerë më eficiente dhe analiza.

KAPITULLI IX

#### **DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE DHE KALIMTARE**

Neni 52

#### **Gjuha zyrtare**

Kjo Rregull publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.



**Neni 53**  
**Ndryshim/plotësimi**

1. ZRRE ka të drejtë të ndryshojë ose plotësoj çdo dispozitë të kësaj Rregulle.
2. Procedurat për ndryshimin ose plotësimin e kësaj Rregulle do të jenë të njëjta si për miratimin e saj.

**Neni 54**  
**Interpretimi**

Në rast se ka paqartësi në lidhje me dispozitat e kësaj Rregulle, Bordi i ZRRE-së, do të nxjerrë interpretime sqaruese.

**Neni 55**  
**Shfuqizimi**

Me hyrjen e fuqi të kësaj Rregulle, shfuqizon Rregullën Nr. 13/2017 për Vlerësimin e Projekteve Kapitale në Rrjetin e Transmisionit dhe Shpërndarjes në Sektorin e Energjisë Elektrike, të miratuar nga Bordi i Zyers së Rregullatorit për Energji me datë 10 maj 2017.


**Neni 56**  
**Hyrja në fuqi**

1. Rregulla hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së.
2. Rregulla publikohet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Bordi i ZRRE-së:

  
Ymer Fejzullahu, Kryesues

  
Lutfije Dervishi, Anëtar

  
Gani Buçaj, Anëtar